



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë, 26/09/2012
Nr. 0204-997

PËR: Isa Mustafa, Kryetar i Komunës së Prishtinës
Sami Hamiti, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Prishtinës

LËNDA: Konfirmim i ligjshmërisë së Vendimeve të Komunës së Prishtinës
NR.0204-997, të pranuar me datë, 26/09/2012

Të nderuar/a

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, Pas shqyrtimit të Vendimeve të miratuara me datë 30/08/2012, nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës, **KONFIRMON** ligjshmërinë e këtyre kteve dhe vlerëson se të njëjtat janë në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.


Aktet juridike të listuara si vijon, kanë efekt të plotë juridik.

- Vendimi për anulimin e vendimit për dhënien e parcelës kadastrale në shfrytëzim Ministrisë së Mbrojtjes së Hungarisë-menaxhmentit për elektronik, logjistik dhe pronë;
- Vendimi për ndryshimin e vendimit për ndërrim të paluajtshmërisë-tokës ndërtimore në pronësi të Komunës së Prishtinës;
- Vendimi për emërimin e këshillit të ekspertëve për planifikim;

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MAPL,

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL-së
Drejtorëve të Departamenteve dhe Zyrave
Arkivit të MAPL-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministërstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Dana 26/09/2012
Br.0204-997

Za: Isa Mustafa, Gradonačelnik Opštine Priština
Sami Hamiti, Predsedavajući Skupštine Opštine Priština

Predmet: Potvrda zakonitosti Odluka Opštine Priština
br.0204-997, primljeno dt, 26/09/2012

Poštovani-e

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, u skladu sa svojim mandatom odredjenim po Zakonu za lokalnu samoupravu br. 03/L-040, dodatak XII Uredbe Vlade 02/2011 o poljima administrativne odgovornosti kancelarije Premijera i Ministarstva, posle razmatranja usvojenih Odluka dana 30/08/2012, od Skupštine Opštine Priština, **POTVRDJUJE** zakonitost ovih akata i procenjuje da su ista u skladu sa Zakonom za lokalnu samoupravu.

Pravna Akta navadena u nastavku, imaju puni pravni efekat .

- Odluka o odlaganju davanja na korišćenje katastarske parcele Ministarstvu Odbrane Madjarske-menadžmentu za elektroniku, logjistiku i imovinu ;
- Odluka o izmeni Odluke za promenu nepokretnosti-gradjevinskog zemljišta u vlasništvu Opštine Priština;
- Odluka o imenovanju saveta eksperata za planiranje;

S poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamenik Premijera i Ministar MALS-a,

Kopija: Besnik Osmani, Generalni Sekretar MALS-a
Direktorima uprava i kancelarija
Arhivu MALS-a.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d të Ligjit nr. 03/L - 040 për vetëqeverisje lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008), të dispozitave të nenit 33, paragrafi, 33.1, pika a e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391 të dt. 25. 02. 2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës në mbledhjen e mbajtur më 30. 08.2012, miratoi këtë

V E N D I M

PËR ANULIMIN E VENDIMIT PËR DHËNIEN E PARCELËS KATASTRALE NË SHFYRTËZIM MINISTRISË SË MBROJTJES SË HUNGARISË - MENAXHMENTIT PËR ELEKTRONIKE, LOGJISTIKE DHE PRONË

I.

Miratohet vendimi për anulimin e vendimit për dhënie e parcelës katastrale në shfrytëzim Ministrisë së Mbrojtjes së Hungarisë - Menxhmentit për elektronike, logjistike dhe pronë (HM EL Zrt) për ndërtimin e Qendrës Rekreative - sportive, 01 nr. 46 - 1064 të dt. 05.06.2009.

II.

Nga dita e miratimit të vendimit të cekur, pushojnë të vlejnë të gjitha dispozitat e vendimit të cekur nga pika I, e këtij vendimi si dhe të gjitha aktet tjera të veçanta të miratuara për zbatimin e këtij vendimi.


III.

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Kataster e Komunës së Prishtinës.

IV.

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë nga dita e publikimit të tij në tabelën e shpalljeve dhe publikimit të tij në WEB faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01. nr. 46-31589 me 30. 08. 2012



KRYETAR I KUVENDIT
Sami Hamiti, ecc. i dipl.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, të nenit 14, paragrafi 14.1, të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008), të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, më 30. 08. 2012, miratoi këtë

V E N D I M
PËR NDRYSHIMIN E VENDIMIT PËR NDËRRIM TË PALUAJTSHMËRISË - TOKËS
NDËRTIMORE NË PRONËSI TË KOMUNËS SË PRISHTINËS

I.

MIRATOHET Vendimi për ndryshimin e Vendimit për ndërrim të paluajtshmërisë - tokës ndërtimore në pronësi të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 46 - 1325, të dt. 11.9.2008.

II.

Pika II e vendimit ndryshon dhe në të thuhet:

"Me këtë vendim, Komuna e Prishtinës ia bart në pronësi tokën ndërtimore, e evidencuar në Zonën kadastrale në Prishtinë, Certifikata e pronësisë nr. 4137, ngastra kadastrale 7490/2, në sipërfaqe prej 4007 m², Ndërmarrjes Publike Banësore, ndërkaq Ndërmarrja Publike Banësore në Prishtinë, në emër të këtij ndërrimi, Komunës së Prishtinës ia bart paluajtshmerinë - tokën ndërtimore, e cila gjendet në Zonën kadastrale në Prishtinë, Certifikata e pronësisë nr. 1915, ngastra kadastrale nr. 7493/1, në sipërfaqe prej 7037 m² dhe në ngastrën kadastrale nr. 7493/2, në sipërfaqe prej 886 m²".

III.

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë nga dita e publikimit të tij në tabelën e shpalljeve dhe ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01. nr. 46-31596, më 30. 08. 2012



KRYESUESI I KUVENDIT
Sami Hamiti, ecc. i dipl.



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008), të dispozitave të nenit 6 të Ligjit nr. 2003/14 për planifikimin hapësinor, të dispozitave të nenit 5 të Ligjit nr. 03/L – 106 për ndryshimin e Ligjit për planifikimin hapësinor nr. 2003/30 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 42/2009), të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, më 30. 08. 2012, miratoi këtë

V E N D I M
P Ë R
EMËRIMIN E KËSHILLIT TË EKSPERTËVE PËR PLANIFIKIM

I.

MIRATOHET Vendimi për emërimin e këshillit të eksperteve për planifikim.

II.

Këshilli i cekur në pikën I të këtij vendimi është në përbërje:

1. Ylber Vokshi, arkitekt i pavarur, kryetar,
2. Luljeta Sokoli, këshilltare e jashtme e Kryetarit, anëtare,
3. Sali Spahiu, arkitekt i pavarur, anëtar,
4. Elvida Pallaska, IPH, anëtare,
5. Venera Demukaj, ekonomiste, prof. Universiteti Amerikan, anëtare,
6. Gëzim Pula, inxhi. i elektrikës, anëtar,
7. Rasim Mjekiqi, inxhi. i makinerisë – ngrohje, anëtar,
8. Faton Deda, inxhi. i makinerisë, energjetikë, anëtar,
9. Agron Nagavci, inxhi. i hidros, anëtar,
10. Luan Shllaku, ekolog, anëtar,
11. Avdi Konjohi, gjeolog, anëtar,
12. Shemsi Krasniqi, urbo – sociolog, anëtar,
13. Haxhi Mehmetaj, IKMM, anëtar,
14. Hajzer Bublaku, jurist, anëtar,
15. Mustafë Shahini, inxhinier, anëtar.

III.

Këshilli do të ofrojë këshilla profesionale në procesin e hartimit të planeve zhvillimore urbane dhe planeve rregulluese urbane, si dhe në procesin e zbatimit të këtyre planeve. Këshilli do të japë mendime, propozime dhe vërejtje edhe në aktet tjera të parapara me Ligjin për planifikimin hapësinor, të cilat i miraton Kuvendi i Komunës.

IV.


Mënyra e punës dhe çështjet tjera me rëndësi për punën e Këshillit të ekspertëve të planifikimit, do të rregullohen me akt të veçantë, të cilin, me propozimin e Këshillit, e miraton Kryetari i Komunës.

V.

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë nga dita e publikimit të tij në tabelën e shpalljeve dhe ueb - faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01. nr. 020-31577 më 30. 08. 2012



KRYESUESI I KUVENDIT
Saim Hamiti, ecc. i dipl.